



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02. Nr. 2744 /2018
Dt: 27.03.2018

Duke u bazuar në, Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1, Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, si dhe pas miratimit dhe autorizimit për rekrutim nga Ministria e Administratës Publike Komuna Hani i Elezit Shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar për Zhvillim**

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Kategoria dhe grada : **(koeficienti 7)¹**

Kohëzgjatja e kontratës: **nëpunës i karrierës ,periudha provuese një vjeqare**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- **Detyra 1:** Koordinimi i aktiviteteve dhe veprimëve për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e PZHK-së apo strategjive të tjera në nivel komune
- **Detyra 2:** Koordinimi dhe bashkërendimi për perputhjen e strategjive të komunës me strategjitë rajonale
- **Detyra 3:** Inkurajimi dhe menaxhim i programeve dhe projekteve në mbështetje të biznesit.
- **Detyra 4:** Hulumtime për çështje të zhvillimit ekonomik dhe të biznesit.
- **Detyra 5:** Mirëmbajtje e statistikave në nivel të komunës
- **Detyra 6:** Jep udhëzime dhe këshilla të ndryshme për mundësin e investimeve, angazhimit të kapitalit, të tyre në veprimtarite prodhuese.
- **Detyra 7:** Inkurajim dhe promovim i zgjerimit të bizneseve dhe sipërmarrjes në komunë kryesisht të SME-ve.
- **Detyra 8:** Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërrmarjeve të vogla dhe të mesme.
- **Detyra 9:** Kryen detyrat tek zyra e investimeve (zyra e biznesëve) ndihmon bizneset me kshilla, plotësimin të aplikacionëve etj.
- **Detyra 10:** Futja e të dhënave të projekteve kapitale në sistemin PIP.
- **Detyra 11:** Rexhistron pasurinë e komunës në sistemin SIMFK.

¹ Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me klasifikimin e vendeve të punës që do të bëhet konform rregullores mbi klasifikimet e vendeve të punës nr.05/2012

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- **Diplom universitare në fushën e Ekonomisë.**
- **2 vite përvojë pune profesionale**
- **Njohje e punës me kompjuter (programet Word, Excel, Office).**
- **Aftesi të mira komunikimi.**
- **Aftesi të mira ndërpersonale dhe kolektive.**

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar për tatimin në pronë**

Drejtoria për buxhet dhe financa

Kategoria dhe grada : **(koeficienti 7)²**

Kohëzgjatja e kontratës: **nëpunës i karrierës ,periudha provuese një vjeqare**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- **Detyra 1:** Është përgjegjës për futjen e saktë të të dhënave në sistemin e tatimit mbi pronë dhe operimin funksional të sistemit
- **Detyra 2:** Viziton objektet e caktuara dhe regjistron pronarin, shfrytëzuesin, klasifikon pronën si dhe përshkruan të dhënat në formularin e aprovuar për shënimet e nevojshme
- **Detyra 3:** Pranon ankesat e tatimit në pronë, krijon dosje për secilën ankesë dhe mban protokoll të rasteve të ankesave derisa ato të shkojnë në Bordin komunal të ankesave për shqyrtim, pas shqyrtimit dhe vendimit të marrë nga bordi i rendit në dosje përkatëse
- **Detyra 4:** Regjistron të gjitha pagesat e tatimit për pronën në sistem
- **Detyra 5:** Shfrytëzon mundësitë e sistemit të tatimit në pronë, identifikon faturat e papaguara tatimore dhe llojin e aksionit që kërkohet sipas procedurave ligjore
- **Detyra 6:** Siguron shpërndarjen e faturave të TP-së, letërkujtesat pas kalimit të afatit, vërejtjet dhe masat konkrete për vjeljen e këtij lloji të tatimit
- **Detyra 7:** Merr veprimet e duhura lidhur me bllokimin e xhirlojarisë bankare për tatimpaguesit që nuk kanë paguar tatimin
- **Detyra 8:** Ndjek trajnime, seminare dhe bashkëpunon me departamentin e TP-së të Ministrisë së Financave
- **Detyra 9:** Përgatit raporte ditore, javore, mujore, vjetore, siç kërkohet nga mbikqyrësi i drejtpërdrejtë
- **Detyra 10:** Bën administrimin e tërësishëm të kësaj pozite dhe sipas nevojës kryen edhe punë tjera me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë përkatëse

² Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me klasifikimin e vendeve të punës që do të bëhet konform rregullores mbi klasifikimet e vendeve të punës nr.05/2012

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- **Diplomë Universitare në fushën e ekonomisë;**
- **0 vite përvojë pune**
- **Njohuri shumë të mira në aplikimin e programeve të Microsoft Office (Word, Excel, Power Point);**
- **Aftësi në komunikim me kolegët e drejtorisë, me kolegët në institucionet tjera dhe qytetarët (palët),**
- **Aftësi të mira ndërpersonale dhe kolektive.**
- **Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.**

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve**

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kategoria dhe grada : **(koeficienti 7)³**

Kohëzgjatja e kontratës: **nëpunës i karrierës ,periudha provuese një vjeqare**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- **Detyra 1:** Organizimi i punëve në pylltari
- **Detyra 2:** Menaxhimi me pyje shtetërore dhe private
- **Detyra 3:** Organizimi i punëve me rojet e pyjeve në lëminë e mbrojtjes së pyjeve
- **Detyra 4:** Organizimi i punëve në shfrytëzimin e pyjeve
- **Detyra 5:** Organizimi i punëve në sivikulturë
- **Detyra 6:** Përcjellja e punëve me operatorët ekonomik në ngastrat e caktuara
- **Detyra 7:** Organizon regjistrimin e tereneve nga dëmet pyjore
- **Detyra 8:** Organizon punën rreth mbrojtjes së pyjeve nga zjarret dhe sëmundjet tjera, koordinon punën me policinë dhe gjykatat
- **Detyra 9:** Bashkëpunon dhe bën raporte të ndryshme me drejtorin
- **Detyra 10:** Kujdeset për dhënien e ndihmës adekuate zyrtarëve lidhur me çështjet brenda fushës së veprimit të sektorit të pylltarisë

³ Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me klasifikimin e vendeve të punës që do të bëhet konform rregullores mbi klasifikimet e vendeve të punës nr.05/2012

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- **Diplom universitare në fushën e Administrimit Publik**
- **2 vite përvojë pune profesionale**
- **Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë**
- **Njohje të punës me kompjuter**
- **Aftësi të mira komunikuese**

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Formularët e aplikimit mund të merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë , çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, dëshmi mbi përvojën e punës tek pozitat ku kërkohet përvoja e punës ,kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe çertifikata tjera nëse posedon.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për test me shkrim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

